UDHËZIM
Nr. 7779/1, datë 24.5.2018

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012, "PËR DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012, "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre", bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 6 e nenit 2 riformulohet si më poshtë:

"6. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor kryejnë kontrollin fizik të mjeteve me dy specialistë të saj, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të nenit 80 të Kodit Rrugor, deri në miratimin prej ministrit të organizmave të akredituar në fushën e mjeteve motorike, për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit dhe të kontrollit fizik të mjeteve motorike rrugore e rimorkiove të tyre. Ministria, gjatë një periudhe pesëvjeçare do të miratojë një numër të kufizuar prej jo më shumë se dy organizmash, për të vlerësuar ecurinë e këtij procesi gjatë kësaj periudhe dhe për të ndërmarrë hapat e mëtejshëm. Këta organizma që do të autorizohen për kryerjen e kontrollit fizik të mjeteve motorike rrugore dhe rimorkiove të ofrojnë këtë shërbim në çdo qendër të kryerjes së kontrollit fizik, me dy specialistë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të nenit 80, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Organizmat mund të disponojnë mjediset ekzistuese pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor për ofrimin e shërbimit, sipas marrëveshjes që do të lidhin me DPSHTRR-në, në përputhje me legjislacionin në fuqi".

2. Pas pikës 7 të nenit 2 shtohen pikat si më poshtë:

"8. DPSHTRR-ja do të vijojë me përdorimin e certifikatave të kontrollit fizik të lëshuara prej organizmave të miratuar, me fillimin e kryerjes së aktivitetit prej tyre, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

9. Modeli i regjistrave fizikë dhe elektronikë i kontrollit fizik të mjeteve dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm me anë të cilit DPSHTRR-ja kryen këtë shërbim, do të vihen në dispozicion të organizmave të miratuar brenda një afati njëmujor nga miratimi i tyre.

10. Certifikatat e kontrollit fizik të mjeteve të emetuara do të mbajnë të njëjtin formatim, përfshirë numrat serialë, si dhe logon dhe të dhënat e organizmit të miratuar.

11. Certifikata e kontrollit fizik të mjetit, të cilit i është kryer kontrolli fizik, i dorëzohet personit të interesuar, i cili, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndjek procedurat për regjistrimin e mjetit.

12. DPSHTRR-ja dhe organizmat e miratuar bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë për zbatimin me korrektësi të procedurave që lidhen me këtë shërbim.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri